REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 172, Datë 15.06.2026

MBI

HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË "KORKIS-2009" SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma "ç" të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar; nenit 5, gërma "ç" dhe nenit 9, gërma "c" të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 6.1, gërma "ç" të *Kushteve të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike*; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 15.06.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 614/3 prot., datë 11.06.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës "*Mbi heqjen e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "KORKIS - 2009" sh.p.k.*",

Konstatoi se:

- Shoqëria "KORKIS - 2009" sh.p.k. është pajisur me licencën nr. 119, seria PV11K, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 21, datë 04.03.2011, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Belesova 1" me fuqi 0.150 MW dhe HEC "Belesova 2" me fuqi 0.280 MW.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 37, datë 04.02.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e kësaj licence, për shkak se shoqëria nuk kishte shlyer në afat pagesën rregullatore të vitit 2025 ndaj ERE-s, duke rezultuar debitore për këtë pagesë, si dhe nuk ka përcjellë në ERE sqarime/dokumentacion mbi moshlyerjen e detyrimit.

- Për vendimin e bordit të ERE-s nr. 37/2026, ERE ka njoftuar dhe MIE-n, nëpërmjet shkresës nr. 614/1 prot., datë 25.03.2026, ku i ka kërkuar gjithashtu qëndrimin e saj në referencë të përcaktimeve të nenit 42, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar, për zbatimin e masës së përkohshme më të përshtatshme dhe më të efektshme për të siguruar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në rast të heqjes së kësaj licence. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Në rrethanat kur nga ana e shoqërisë nuk kishte asnjë reagim në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës është telefonuar në numrin që ERE disponon, nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë është bërë me dije se HEC-i nuk prodhon më energji elektrike dhe për këtë fakt ka lajmëruar Ministrinë, duke i kërkuar zgjidhjen e kontratës së koncesionit. Nga ana e ERE-s është sqaruar se i licencuari nuk e ka njoftuar ERE-n për këtë fakt në kohë, në mënyrë që kjo

të vlerësohej dhe në kuadër të caktimit të pagesës rregullatore përkatëse, si e tillë tashmë pagesa rregullatore është bërë titull ekzekutiv dhe duhet të vijohet me shlyerjen e saj.

- Në vijim me shkresën e saj nr. 403 prot., datë 03.04.2026, protokolluar në ERE me nr. 614/2 prot., datë 03.04.2026, shoqëria ka bërë me dije, ndër të tjera, se nuk e ushtron veprimtarinë e licencuar dhe ka dokumentuar se është në proces gjyqësor me MIE-n për zgjidhjen e kontratës së koncesionit.

- Për gjithë sa më sipër, në rrethanat kur shoqëria vetë ka bërë me dije dhe ka dokumentuar në ERE se ka paraqitur kërkesë-padinë në Gjykatë për zgjidhjen e kontratës së koncesionit për shkak të mosushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i, vlerësohet të vijohet me heqjen e licencës.

- Në nenin 42, pika 1, gërma "ç" të ligjit nr. 43/2015, "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar, në nenin 5, gërma "ç" të "*Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe në pikën 6.1, gërma "ç", të "*Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike*", parashikohet se: *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.*

- Me heqjen e kësaj licence, shoqëria nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE.

- Pavarësisht vendimit për heqjen e licencës, shoqëria nuk çlirohet nga detyrimi për të shlyer debinë përkatëse për vitin 2025, si dhe pagesën rregullatore të vitit 2026 (miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 63, datë 26.02.2026), si dhe kamatëvonesat, detyrim ky që i ka lindur shoqërisë ndërkohë që ishte e licencuar nga ERE. Vjelja e këtyre detyrimeve do të bëhet me rrugë gjyqësore, sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Në nenin 37, pika 6, gërma "b" të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", i ndryshuar, dhe në nenin 4, pika 3, gërma "b" të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, parashikohet se prodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar me kapacitet të instaluar deri në 1 MW nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të heqë licencën nr. 119, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "KORKIS-2009" sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 21, datë 04.03.2011.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca nr. 119, seria PV11K, bëhet e pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "KORKIS 2009" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, "OSSH" sh.a., "FTL" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI